

Ilaçi dhe sëmundja e demencës

FLETË FAKTESH NGA QENDRA SUEDEZE E DEMENCËS

Läkemedel och demenssjukdom • faktablad på Albanska

Ilaçi mund të zbusë simptomën

Sëmundjet e demencës, të quajtura edhe sëmundjet kognitive të shpien në lëndime të ndryshme të trurit. Ato ndikojnë në kujtesën, në aftësitë e të menduarit dhe gjuhësore dhe funksione të tjera të ashtuquajtura njohëse. Prandaj, detyrat e thjeshta bëhen më të vështira për t'u zbatuar dhe gradualisht keni nevojë për më shumë ndihmë për të përballuar jetën tuaj të përditshme.

Sot nuk ka mjet shërimi ndaj sëmundjeve të demencës. Megjithatë, ka ilaçe të cilat në shumë raste, mund të pengojnë simptomat e sëmundjes së Alzheimerit, sëmundjes më të zakonshme të demencës. Disa gjithashtu mund të ndikojnë pozitivisht në demencën e trupit *Lewy* dhe sëmundjen e *Parkinsonit* me demencë.

Katër lëndët aktive

Ka katër lëndë aktive të cilat mund të ndikojnë në simptomën. Ato janë përbërës i ilaçeve të ndryshme, të cilat shiten në barnatore, me emra të ndryshëm. Tri nga substancat aktive njihen me emrin e përbashkët *frenuesit e kolinesterazës* dhe rekomandohen në fazat e hershme të demencës.

- . Donepezil
- . Galantamin
- . Rivastigmin

Të tri substancat e vonojnë shpërbërjen e *acetilkolinës*, një substancë sinjalizuese në tru. Në këtë mënyrë, ato mund të kompensojnë prodhimin e reduktuar të acetilkolinës që sjell sëmundjen e Alzheimerit. Kjo bën që kujtesa, të mësuarit dhe përqendrimi dhe aftësia e gjuhës, mund të funksionojnë më mirë për një kohë dhe kjo kontribuon që aktivitetet e përditshme, të bëhen më të lehta.

Më vonë gjatë progresit të gjendjes

Memantina është substanca e katërt aktive. Ndonjëherë rekomandohet si shtesë për frenuesit e kolinesterazës (shih më lart), por gjithashtu mund të funksionojë pak më vonë gjatë progresit të gjendjes.

Për shkak se memantina e përmirëson transmetimin e sinjaleve të caktuara nervore në tru, ju mund të jeni në një gjendje disi më të mirë. Edhe simptomat

e sjelljes mund të përmirësohen. Megjithatë, efektet mund të ndryshojnë nga personi në person. Kjo vlen për të katra substancat aktive.

Mund të kenë pasoja anësore

Mund të shfaqen efekte anësore të tilla si përzierje, dhimbje koke dhe ulje të oreksit. Shpesh këto janë kalimtare. Përndryshe, kontakto mjekun tënd ose infermieren.

Është e rëndësishme që trajtimi juaj mjekësor të monitorohet. Mjeku mund të ketë nevojë të korrigjoj dozimin ose të ndërroj ilaçin. Mjeku, po ashtu, ka nevojë të vlerësojë dobitë e trajtimit.

Barnatorja jep këshilla

Barnatorja, ndonjëherë propozon një ilaç tjetër, nga ai që të ka rekomanduar mjeku. Në këtë rast, ai duhet të jetë një ilaç që përmban të njëjtën substancë aktive dhe për këtë arsye ka të njëjtin efekt. Për efektet anësore dhe mënyrën se si duhet të merret ilaçi mund të merrni informacion në farmaci.

Mos hezitoni të pyesni mjekun tuaj për paketat e dozave; ato e lehtësojnë monitorimin e barnave.

2022 • Svenskt Demenscentrum ©

Mjeku im ka rekomanduar lënden aktive:

Është në formë ilaçi në barnatore, nën emrin:

Më shumë informacion në gjuhë të ndryshme, mund të printohet nga faqja e internetit e Qendrës Suedeze të Demencës në: demenscentrum.se/Faktablad



Svenskt Demenscentrum

Qendra suedeze e demencës, (Svenskt Demenscentrum, Sveavägen 155, 113 46 Stockholm), 08-690 58 00, info@demenscentrum.se

www.demenscentrum.se

